



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 4 dhe 6 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga buxheti i Komunës 15Nr. 011-23133 e datës 06.05.2015, Vendimit për përcaktimin e shumës për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan për mbulimin e shpenzimeve të varrimit 15Nr.400-45612 i datës 12.11.2014 si dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 04. 04. 2016, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratojë këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË
ISLAME NË LIPJAN

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan në shumë prej **12.100,00€**, (dymbëdhjetë mijë e njëqind euro), për subvencionimin – mbulimin e shpenzimeve të varrimeve për 110 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur prej datës 28.10.2015 deri më 29.02.2016 me nga 110 Euro për secilin rast $110 \times 110 = 12.100$.

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2016.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. -400 -17250
Lipjan, më 05. 04. 2016

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT

KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani-Hajruni

